

VENDIM
Nr. 74, datë 20.11.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahimimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 20.11.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 6 (B) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bibë Kaza, përfaqësuar nga avokat Ndue Marku, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3570, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 45, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Bibë Kaza (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka shërbyer si oficer aktiv në Forcat e Armatosura nga data 18.5.1981 deri në datën 1.8.2004, kur ka dalë në rezervë me gradën “Kolonel” dhe me vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv për 23 vjet e 2 muaj.

2. Pas përfundimit të trajtimit me pagesë kalimtare, në datën 1.8.2006, kërkuesi është trajtuar në vijim me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi (*pensioni i parakohshëm*). Me vendimin nr. 4168, datë 25.1.2008 (*vendimi nr. 4168/2008*) DRSSH-ja, Tiranë i ka caktuar atij pensionin e

parakohshëm, me të drejtë pagese nga data 1.8.2006, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie. Pensioni është përlllogaritur në bazë të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8087/1996*), duke u përcaktuar në masën 16.007 lekë në muaj, sa pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi. Kërkuesi ka paraqitur disa kërkesa për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm pranë DRSSH-së, Tiranë, por nuk ka marrë përgjigje.

3. Më pas, ai i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së, Tiranë: i. të rillogarisë dhe të paguajë masën e pensionit të parakohshëm në përputhje me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9210/2004*), për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, duke përfshirë indeksimin vjetor të pensionit; ii. të paguajë diferencat midis masës së pensionit të rillogaritur dhe atij të paguar për të njëjtën periudhë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4655 (80-2015-3038), datë 25.9.2015, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit, sipas objektit të saj. Ajo ka arsyetuar se, edhe pse në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm ishte në fuqi ligji nr. 9418, datë 20.5.2005, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 9418/2005*), në mungesë të akteve nënligjore për zbatimin e tij, caktimi dhe llogaritja e masës së pensionit me të drejtë janë bazuar në ligjin nr. 8087/1996. Megjithatë, organi i sigurimeve shoqërore ka gabuar kur, për periudhën objekt gjykimi 1.8.2006–30.6.2009 ka kufizuar masën e pensionit të parakohshëm sipas nenit 11, shkronja “b”, të këtij ligji, në kushtet kur, nga data 14.5.2004, shprehja: “por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi”, në shkronjën “b” të këtij neni ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Referuar ekspertimit gjyqësor, diferenca e papaguar e pensionit të parakohshëm për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, është 3.111.328 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1690 (1684), datë 20.4.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Ajo ka arsyetuar se, ndonëse në datën 1.8.2006, të lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm në fuqi ishte ligji nr. 9418/2005, bazuar në vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 3/2016*), ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të tij është ligji nr. 8087/1996, përfshirë edhe kufizimin e masës së pensionit sipas nenit 11, shkronja “b”, të tij sa masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Për rrjedhojë, pensioni i parakohshëm për kërkuesin është caktuar dhe paguar në përputhje me ligjin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3570, datë 19.9.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas këtij kolegji, shkaqeve në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme, konkretisht të ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), duke e zgjidhur çështjen në meritë në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016.

7. Në datën 13.2.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, u regjistrua në datën 24.2.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 23.4.2025, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, për shkak se:

8.1 Gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të parashtruara përpara shqyrtimit të çështjes, të cilat as nuk i ka pasqyruar në vendimin e saj. Po kështu, ajo ka dalë përtej kufijve të ankimit të palës së paditur, duke u investuar kryesisht për çështje që nuk janë ngritur në ankim. Arsytimi i vendimit të saj nuk përputhet me faktet dhe me situatën juridike të çështjes, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe jologjik. Në planin material, gjykata e apelit nuk ka zbatuar ligjin sipas përmbajtjes së tij në çastin e lindjes të së drejtës. Ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka përcaktuar si të zbatueshëm ligjin nr. 8087/1996 bashkë me kufizimin e masës së pensionit në nenin 11 të tij. Megjithatë, një zbatim i tillë i ligjit bie haptazi ndesh me parimin e ligjshmërisë, pasi mungesa e akteve nënligjore nuk e bën të pazbatueshëm nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, i cili zbatohet drejtpërdrejt. Për pasojë, vijon kërkuesi, është sjellë në fuqi një normë e shfuqizuar 12 vjet më parë, duke marrë kompetencat e pushtetit legjislativ dhe duke mos zbatuar ligjin në mënyrë uniforme, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Kushtetutës, por edhe të parimit të sigurisë juridike, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës.

8.2 Edhe pse në rekursin e tij janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por edhe për shkelje të rënda të ligjit material dhe atij procedural nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mbajtur qëndrim formal, skematik dhe të thjeshtëzuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimin e kundërshtuar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhënë në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga ai, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu i kundërshtuar në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës saj, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 24, datë 23.4.2025; nr. 77, datë 5.11.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuuesi nuk ka qenë palë në procesin ku është dhënë vendimi unifikues i kundërshtuar, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues, për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Në drejtim të legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 19.9.2024 dhe sipas korrespondencës së kërkuarit me atë gjykatë, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, ai vendim është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 14.10.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 13.2.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, por edhe të parimit të sigurisë juridike, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Nisur nga thelbi i pretendimeve, që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

15. Kërkuuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara përpara shqyrtimit të çështjes, të cilat as nuk i ka pasqyruar në vendimin e saj. Po kështu, ajo ka dalë përtej kufijve të ankimit të palës së paditur, duke u investuar kryesisht për çështje që nuk janë ngritur në ankim. Arsyeimi i vendimit të saj, sipas kërkuarit, nuk përputhet me faktet dhe situatën juridike të çështjes, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe jologjik. Në planin material, gjykata e apelit nuk ka zbatuar ligjin sipas përmbajtjes së tij në çastin e lindjes të së drejtës. Ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka përcaktuar si të zbatueshëm ligjin nr. 8087/1996, bashkë me kufizimin e masës së pensionit në nenin 11 të tij. Megjithatë, një zbatim i tillë i ligjit bie haptazi ndesh me parimin e ligjshmërisë, pasi mungesa e akteve nënligjore nuk e bën të pazbatueshëm nenin 49, të ligjit nr. 9210/2004, i cili zbatohet drejtpërdrejt. Për pasojë, vijon kërkuuesi, është sjellë në fuqi një normë e shfuqizuar 12 vjet më parë, duke marrë kompetencat e pushtetit legjislativ dhe duke mos zbatuar ligjin në mënyrë uniforme, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Kushtetutës, por edhe të parimit të sigurisë juridike, të

garantuar nga neni 4 i Kushtetutës. Edhe Gjykata e Lartë, shprehet kërkuuesi, ndonëse në rekursin e tij janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por edhe për shkelje të rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mbajtur qëndrim formal, skematik dhe të thjeshtëzuar.

16. Duke sjellë në vëmendje se neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon edhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon të ritheksojë se roli i saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë. Ajo nuk vepron si “gjykatë e shkallës së katërt”, ndaj ndërhyrja e saj justifikohet vetëm kur gjetjet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra kur gabimi ligjor ose faktik nga ato është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 24, datë 23.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata çmon të ritheksojë se ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpiten në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohen sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 78, datë 6.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 1, datë 31.1.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata rithekson gjithashtu se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës së ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me

funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tyre kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuere të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, Gjykata e ka bërë tashmë në disa raste (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 24, datë 23.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), ndaj çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

21. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuarit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata, në vijim, do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuarit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuarit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

22. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuarit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 1.8.2006. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 16.007 lekë në muaj, sipas aktit administrativ, vendimit nr. 4168/2008 të DRSSH-së, Tiranë. Ai ka kërkuar nga kjo e fundit, në disa raste, rillogaritjen e masës së pensionit, por nuk ka marrë përgjigje. Pas kësaj, kërkuari i është drejtuar gjykatës administrative, duke kërkuar detyrimin e organit administrativ t'i rillogarisë dhe t'i paguajë atij pensionin e parakohshëm për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, në përputhje me masën e përcaktuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, si dhe t'i paguajë diferencat midis masës së pensionit të rillogaritur dhe atij të paguar, për të njëjtën periudhë.

23. Padia e kërkuarit është pranuar nga gjykata administrative e shkallës së parë. Ajo ka arsyetuar se, edhe pse në çastin e lindjes për kërkuarin të së drejtës për pension të parakohshëm ishte në fuqi ligji nr. 9418/2005, në mungesë të akteve nënligjore për zbatimin e tij, caktimi dhe llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm me të drejtë është bazuar në ligjin nr. 8087/1996. Megjithatë, sipas saj, organi i sigurimeve shoqërore ka gabuar kur për periudhën objekt gjykimi 1.8.2006–30.6.2009 ka kufizuar masën e pensionit të parakohshëm sipas nenit 11, shkronja “b”, të këtij ligji, në kushtet kur nga data 14.5.2004, shprehja: “por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi”, në shkronjën “b” të këtij neni ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Për pasojë, sipas asaj gjykate, llogaritja dhe pagimi i pensionit të parakohshëm për kërkuarin janë në kundërshtim me ligjin dhe referuar ekspertimit gjyqësor, diferenca e papaguar për periudhën 1.8.2006–30.6.2009 është 3.111.328 lekë.

24. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuarit. Edhe sipas gjykatës së apelit, ndonëse në datën 1.8.2006 të lindjes për kërkuarin të së drejtës për pension të parakohshëm në fuqi ishte ligji nr. 9418/2005, bazuar në vendimin unifikues nr. 3/2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të tij ishte ligji nr. 8087/1996, përfshirë edhe kufizimin e masës së pensionit, sipas nenit 11,

shkronja “b”, të tij, sa masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, pensioni i parakohshëm për kërkuesin është caktuar dhe paguar në përputhje me ligjin.

25. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012 dhe se pretendimeve në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme dhe e ka zgjidhur çështjen në meritë në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Po sipas tij, nuk ka zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural nga Gjykata Administrative e Apelit dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

26. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 1.8.2006. Në atë kohë kjo e drejtë rregullohej nga nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, të cilat përcaktonin kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm dhe masën e tij, konkretisht 50% të pagës referuese dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm (15 vjet për meshkujt), masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese, me kufizimin se për ushtarakët me gradën “Kolonel” masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të ishte më e madhe se 5-fishi i pensionit bazë. Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004, të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, sipas shkronjës “b”, të nenit 11, të ligjit nr. 8087/1996, si dhe parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 9418/2005, sipas të cilit, me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se do të përfitonte nga këto dispozita, pra se ndaj atij nuk do të zbatohet tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm (referuar ligjit nr. 9210/2004) ose që ky kufizim do të ishte deri në 5-fishin e pensionit bazë (referuar ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006).

27. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht ligjit në fuqi në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm, konkretisht të ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se ky ligj nuk zbatohet, por zbatohet ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, megjithëse neni 33 i ligjit të parë parashikonte shprehimisht se ky i dyti nuk do të zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që përfitonin sipas këtij ligji (ligjit të parë). Për këtë, ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin, duke iu referuar nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, është arritur në përfundimin se për periudhën nga data 1.1.1999 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi përllogaritet sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), përfshirë edhe përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kohën kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), i cili nuk zbatohet. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29, të ligjit nr. 10142/2009 është në përputhje me Kushtetutën, sikurse edhe Gjykata ka vlerësuar në vendimet nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013. Megjithatë, Gjykata vëren se neni 29, i ligjit nr. 10142/2009 rregullon rilogaritjen e të drejtave të njohura dhe pika 1 e tij përcakton zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8087/1996, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (nr. 10142/2009), duke mos u shprehur për ndonjë efekt prapaveprues të ligjit në fjalë dhe as për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 ose rregullimin ndryshe të pasojave të ardhura nga zbatimi i tij. Po kështu, edhe në vendimet e referuara të Gjykatës nuk ka ndonjë vlerësim për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 për periudhën që ai ka qenë në fuqi dhe as për zbatimin në mënyrë përjashtimore me efekt prapaveprues të ligjit nr.

10142/2009, pra me qëllim rregullimin e ndonjë prej atyre situatave, të cilat, në aspektin kushtetues, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, do të lejonin, përjashtimisht, zbatimin me efekt prapaveprues të këtij ligji ndaj situatave ose marrëdhënieve të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi.

28. Përtej kësaj, Gjykata konstaton se ndonëse tavan i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004, Gjykata Administrative e Apelit e kufizoi pensionin e parakohshëm të kërkuesit për periudhën 1.8.2006–30.6.2009 në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke u mbështetur në nenin 11, të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohej për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij.

29. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë për llogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se përmbush kërkesat e gjykimit të drejtë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

30. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar përmbajtjen e ligjit nr. 9210/2004 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyrën e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit. Ajo nuk shprehet as për arsyet se përse ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, i identifikuar nga të dyja gjykatat më të ulëta si ligji në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, është i pazbatueshëm për periudhën 1.8.2006–30.6.2009. Po kështu, ajo nuk shpjegon se përse në rastin konkret kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 për këtë periudhë dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm edhe nga gjykata e apelit (ligji nr. 8087/1996) vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar, sikurse ka pranuar gjykata e shkallës së parë. Për pasojë, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm, sikundër edhe për sa i përket zbatimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

31. Në rrethanat si më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve në rekurs të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke mbajtur në veçanti qëndrim për sa i përket kufizimit të masës së pensionit të kërkuesit për periudhën 1.8.2006–30.6.2009. Prandaj, vendimi i saj cenon të drejtën e kërkuesit për gjykim të drejtë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimin e sigurisë juridike për të drejtën e pensionit të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji.

32. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit është i bazuar. Megjithatë, duke pasur parasysh rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material, prandaj vendimi i saj duhet të shfuqizohet.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3570, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Marrë më 20.11.2025.
Shpallur më 24.12.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini